

Formulari- F2



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 1299

Datë: 18/07/2025

**RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES
MASTER**

FAKULTETI	
Departamenti/ Programi	Prodhimtari dhe Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti
Projektpropozimi	Programimi dhe analiza e funksionimit të makinave paketuuese të produkteve ushqimore në kompaninë Ananas Impex <i>Programming and functional analysis of food packaging machines at Ananas Impex company</i>
Kandidati	BSc. Aurela Tahiri
Mentori	Prof. Dr. Ramë Likaj
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: Vendimi nr.:
<p>Vlerësimi i dorëshkrimit</p> <p>Në bazë të vendimit nr. <u>1125/24</u> të datës <u>25.07.2024</u>, të Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, është formuar komisioni në përbërje:</p> <ol style="list-style-type: none"> Prof. Dr. Mirlind Bruqi, kryetar Prof. Asoc.Dr. Afrim Gjelaj, anëtar Prof. Dr. Ramë Likaj, mentor <p>Për vlerësimin e punimit Master me titull "Programimi dhe analiza e funksionimit të makinave paketuuese të produkteve ushqimore në kompaninë Ananas Impex" të kandidatës Aurela Tahiri.</p> <p>Pas shqyrtimit të punimit të lartpërmendur, Komisioni jep këtë:</p> <p style="text-align: center;">R A P O R T</p> <p>Punimi Master me titull "Programimi dhe analiza e funksionimit të makinave paketuuese të produkteve ushqimore në kompaninë Ananas Impex" është strukturuar në kapituj kryesorë dhe është ilustruar me figura, grafe dhe fotografi të nevojshme.</p>	

Hyrje

Ky kapitull paraqet rëndësinë e industrisë së paketimit e cila është një fushë ndërdisiplinore, e cila ndërthur njohuritë nga inxhinieria mekanike, kimia dhe dizajni industrial.

Në këtë pjesë është përshkruar edhe identifikimi dhe përshkrimi i problemeve gjatë programimit dhe funksionimit të makinave paketuese që përbën një hap kyç për të garantuar efikasitet dhe cilësi në procesin e paketimit. Ndërsa rasti studimor ka të bëjë me kompaninë “Ananas Impex”, në të cilën paktohen produkte si speci i kuq, erëza dhe lloje të ndryshme salcash, duke përdorur disa tipe makinash paketuese, kryesisht ato të tipit vertikal.

Bazat teorike të paketimit të produkteve ushqimore

Kapitulli ofron një përmbledhje lidhur me dizajnin e paketimit, që i referohet krijimit të paketave ose mbështjellësve që për nga pamja vizuale duhet të jenë tërheqëse për konsumatorin dhe funksionale për produktet duke përfshirë:

- Qëllimet e paketimit të produkteve ushqimore,
- Tipet e paketimit të produkteve ushqimore,
- Materialet e paketimit të produkteve ushqimore,
- Kërkesat për paketimin e produkteve ushqimore,
- Teknologjitë e reja në paketimin e produkteve ushqimore.

Teknologjia e makinave paketuese

Në këtë kapitull janë shqyrtuar makinat paketuese dhe përdorimi i teknologjive të avancuara dhe të integruara me sisteme tjera për menaxhimin e proceseve prodhuese si:

- Llojet e makinave paketuese,
- Funksionimi i makinave paketuese,
- Programi i makinave paketuese,
- Integrimi i teknologjive të avancuara në makinat paketuese.

Programimi dhe funksionimi i makinave paketues. Rast studimi “Ananas Impex”

Në këtë pjesë është përshkruar në mënyrë të detajuar funksionimi i makinave paketuese, në rastin tonë funksionimi dhe paketimi i makinës paketuese vertikale për paketim të specit të bluar.

Ky kapitull përfshinë:

- Pjesët përbërëse të makinës paketuese vertikale,
- Programimi i makinës paketuese vertikale,
- Funksionimi i makinës paketuese vertikale për paketim të specit të kuq të bluar.

Përfundimet

Në këtë kapitull përmbledhen gjetjet kryesore të hulumtimit nga rasti studimor i kompanisë ANANAS IMPEX, duke analizuar dhe studiuar linjën paketuese, janë vlerësuar aspektet teknike dhe funksionale të pajisjes, përfshirë ciklin e punës, parametrat e programimit, si dhe




Formulari- F2

ndërveprimi i komponentëve elektromekanikë dhe sensorikë që garantojnë saktësinë dhe efikasitetin në paketim.

PËRFUNDIM

Në bazë të të dhënave të përshkruara më lart, Komisioni për Vlerësimin e punimit Master konsideron se punimi është hartuar në nivel të duhur, i pasqyruar me figura, diagrame dhe tabela të nevojshme. Prandaj, komisioni i propozon Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, që punimin Master me titull **“Programimi dhe analiza e funksionimit të makinave paketuese të produkteve ushqimore në kompaninë “Ananas Impex”** të kandidatës **Aurela Tahiri**, ta aprovojë si punim për Master dhe ta japë në diskutim publik.

Prishtinë, Komisioni:

1. 
Prof. Dr. Ramë Ljkaj – mentor
2. 
Prof. Asoc. Dr. Afrim Gjellaj – anëtar
3. 
Prof. Dr. Mirlind Bruqi – anëtar

ABSTRAKTI

Industria e paketimit përfshin projektimin, prodhimin, testimin dhe vlerësimin e paketimit për operacione tregtare. Ajo përfaqëson një hallkë thelbësore që lidh prodhuesit me konsumatorët në sektorë të ndryshëm, përfshirë industrinë farmaceutike, ushqimore, elektrike, të produkteve të përditshme dhe asaj inxhinierike. Inxhinieria e paketimit është një fushë ndërdisiplinore, e cila ndërthur njohuritë nga inxhinieria mekanike, kimia dhe dizajni industrial.

Identifikimi dhe përshkrimi i problemeve gjatë programimit dhe funksionimit të makinave paketuese përbën një hap kyç për të garantuar efikasitet dhe cilësi në procesin e paketimit. Në kompaninë "Ananas Impex", paketohen produkte si speci i kuq, erëza dhe lloje të ndryshme salcash, duke përdorur disa tipe makinash paketuese, kryesisht të tipit vertikal. Problemet më të zakonshme përfshijnë:

- Probleme mekanike si bllokimet dhe ndaljet e papritura,
- Mospërputhje në mbylljen e paketave,
- Mosfunksionime të komponentëve,
- Çështje të cilësisë së produktit për shkak të parametrave të pasaktë,
- Probleme me softuerin e kontrollit, përfshirë gabime në programim dhe mungesë të integritimit ndërmjet moduleve.

Ky punim synon të shqyrtojë në mënyrë të detajuar programimin dhe funksionimin e makinave paketuese, me fokus të veçantë në makinat vertikale të përdorura në kompaninë "Ananas Impex". Qëllimi kryesor është analizimi i efikasitetit të proceseve të automatizuara dhe ndikimi i teknologjive të programimit, veçanërisht përmes kontrolluesve logjikë të programueshëm (PLC), në përmirësimin e cilësisë së paketimit dhe rritjen e produktivitetit industrial.

Hulumtimi bazohet në literaturë shkencore dhe në të dhëna primare të mbledhura përmes intervistës me menaxherin e prodhimit si dhe përvojës së fituar gjatë praktikës profesionale dhe punës në kompani. Rasti studimor përfshin një përshkrim hap pas hapi të programimit dhe funksionimit të makinës paketuese, duke analizuar parametrat kryesorë teknikë dhe qështjet operative.

Në përfundim, rezultatet e analizës konfirmojnë hipotezat e ngritura dhe nxjerrin përfundime të rëndësishme për përmirësimin e proceseve të prodhimit dhe paketimit në industrinë ushqimore, me qëllim rritjen e efikasitetit, cilësisë dhe qëndrueshmërisë së operacioneve.